

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2009

Viti 2009 ishte vit i sukseseve, si në veprimtarinë bibliotekare, realizimin e shërbimeve, ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve kulturore. E posaçërisht në pasurimin bibliotekës me tituj të rinj. Në këtë raport janë paraqitur segmentet e veçantë të veprimtarisë bibliotekare dhe aktiviteteve kulturor që janë zhvilluar gjatë vitit 2009 në bibliotekën ndërkomunale “Hivzi Sulejmani” të Prishtinës.

Punët profesionale

Përveç punëve profesionale si: përpunimi i librit, klasifikimi, katalogimi, printimi, puna me lexues etj., të cilat janë kryer në mënyrë profesionale, janë përpunuar shumica e librave që kanë hyrë në bibliotekë gjatë këtij viti si dhe janë hartuar projekte për pasurimin e fondeve të bibliotekës dhe degëve të saj, janë mbledhur dhe hartuar raportet dhe planifikimet vjetore të punës që janë shqyrtuar dhe analizuar në Kolegjin profesional të bibliotekës dhe janë dhënë sugjerime e propozime për ngritjen e efikasitetit të punës.

Vitin e kaluar biblioteka ka startuar me Programin për biblioteka ALEPH 500, gjegjësisht me modulën e katalogimit. Biblioteka ka filluar punën e katalogimit sipas këtij programi me sukses në tetor të vitit 2008 dhe po vazhdon me intensitet këtë punë.

Puna e Kolegjit Profesional

Në çdo tre muaj janë shqyrtuar raportet periodike nga Kolegji Profesional i Bibliotekës dhe pas analizës së punës të çdo sektori e dege, janë dhënë vërejtje, sugjerime, këshilla, plotësime etj., me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve në raport me përdoruesit për dhënie të informacionit.

Koordinimi i punës me bibliotekat komunale

Me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe zhvillimit të veprimtarisë bibliotekare në bibliotekat komunale në Lypjan, Fushë Kosovë, Kastriot, Besianë dhe Drenas, mbikëqyrjen profesionale të të cilave, bazuar në Ligjin për biblioteka, e ka për detyrë biblioteka jonë, gjatë këtij viti ka pasur kontakte, konsultime rreth punës profesionale dhe organizimit të sektorëve. Kontakto janë mbajtur edhe me qeveritë komunale të këtyre bibliotekave, si Lypjan, Besianë, Drenas, Kastriot e Fushë Kosovë dhe është kërkuar prej tyre që t’i përkrahin më shumë për ato biblioteka në pasurimin e fondit të koleksioneve, në ngritjen profesionale të punonjësve dhe renovimin e objekteve.

Trajnimet

- Këtë vit në bibliotekën është trajnuar për punë profesionale të bibliotekës një kandidat. Ajo mori njohuri të përgjithshme për punën me lexues, klasifikimin dhe

katalogimin. Gjithashtu u pajis edhe material profesional që do t'i duhet në të ardhmen.

- Dy punëtorë të bibliotekës e patën një trajnim 8 ditor në BKUK për përvetësimin e punës në programin ALEPH 500, në modulën e Pasurimit.

Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe periodikut

- Viti 2009 ka arritur rekord sa i përket pasurimit të bibliotekës me tituj të rinj. Kanë hyrë në bibliotekë këtë vit 1237 tituj me 10108 kopje të librit të financuara nga Drejtoria për Arsim dhe Kulturë e Komunës së Prishtinës, nga blerja me mjete të bibliotekës në Panairin e librit në Prishtinë dhe në Tiranë dhe dhurimit nga persona dashamirës dhe miq të bibliotekës.
- Gjithashtu furnizimi me periodik ishte i kënaqshëm. Në bibliotekën qendrore janë marrë gazeta të përditshme, të cilat u janë dhënë në shërbim lexuesve: "Koha ditore", "Zëri", "Epoka e re", "Lajmi", "Bota Sot", "Express" dhe revistën "Kosovarja" dhe "Pionieri". Sikurse viteve të tjera, u bë lidhja e tri gazetave ditore: "Bota sot", "Koha ditore", dhe "Zëri".

Aktivite bibliotekare

- Java e bibliotekës, ngjarja më me rëndësi për bibliotekat dhe bibliotekarët e Kosovës e mbajtur 14-18 prill ishte e mbushur me aktivitete të larmishme kulturore dhe profesionale. Kenneth Oberembt shtjelloj tema të ndryshme profesionale. Interesimi i bibliotekarëve të Kosovës për këto tema ishte i madh. Kishte edhe ekspozita, promovime të librave të reja. Shtëpia botuese "Dukagjini" dhuroi 10 000 libra për bibliotekat e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë, Preshevës dhe Malit të Zi.
- 23 -24 nëntor në BKUK u mbajt edicioni i katërt i konferencës kombëtare të bibliotekonomisë me temën : Nga Bibliografia te Webografia e librit shqip". Me kumtesa u paraqitën njohësit me të mirë të bibliotekarisë nga Shqipëria dhe nga Kosova.
- Panairi i librit i 11 me radhë u mbajt në Prishtinë me 3 -9 qershor solli botime të reja nga mbarë trevat shqiptare. Biblioteka u pasurua me tituj të rinj të librave për të rritur dhe fëmije, kryesisht botime të reja të vlefshme për bibliotekën.
- Gjithashtu në nëntor të vitit 2009 një ekip i bibliotekës mori pjesë në Panairin e librit në Tiranë dhe bleu libra me vlerë, posaçërisht botimet e fundit të librit shqip nga të gjitha trevat shqiptare.

- Në bibliotekën Ndërkomunale “ Ibrahim Rugova” të Gjakovës u mbajt një trajnim dyditor i cili u përkrah nga Ministria e Kulturës me tema nga bibliotekaria duke filluar nga klasifikimi, katalogimi, puna me lexues etj., me punëtorët e bibliotekave në degët në fshatra dhe të bibliotekave komunale. Në këtë trajnim morën pjesë disa punëtor nga biblioteka jonë dhe bibliotekat komunale.
- Me 3-4 shtator Biblioteka Kombëtare dhe Universitare në bashkëpunim me Bibliotekën Ndërkomunale të Prizrenit organizuan një seminar dyditor me temën : Bibliotekat e Kosovës midis tradicionales dhe modernes. Pjesëmarrja dhe interesimi ishte shumë i lartë, nga të gjitha llojet e bibliotekave në Kosovë dhe trajtuan tema nga bibliotekaria. Nga biblioteka jonë me temën : “Bibliotekat moderne dhe bashkëpunimi me komunitetin”, u paraqit Fatime Mehmetaj. Në fund u nga pjesëmarrësit u dhanë propozime për përmirësimin e gjendjes së bibliotekave të Kosovës. Të gjithë pjesëmarrësit u pajisën me dëshmi për ndjekjen e seminarit.

Aktivitetet kulturore:

- Me qëllim të vetëdijesimit të rinisë me problemet dhe pasojat që shkakton droga tek rinia, familja dhe shoqëria jonë, në degën “Përkujtimore” me 13.02.2009 u mbajt një ligjëratë nga një ekip ekspertësh të kësaj fushe. Ligjëratën e dëgjuan nxënësit e klasave të nënta të sh. f. “Gjergj Fishta”, shumica prej të cilëve janë lexues të rregullt të bibliotekës sonë. Interesimi ishte shumë i madh, gjë që u vërejt nga pyetjet e shumta që lexuesit bënë për ekspertët. Ata shpërndanë fletushka me 100 pyetje dhe 100 përgjigje për drogën për të gjithë pjesëmarrësit.
- Në degën “ Biblioteka Përkujtimore” RTK po realizon emisionin televiziv “Libër i hapur” . Këtë vit është bërë realizimi me sukses i disa emisioneve në bashkëpunim me punëtorët dhe lexuesit e kësaj biblioteke. Në këto emisione janë prezantuar veprat e shumë shkrimtarëve tonë të njohur. Kjo traditë do të vazhdojë edhe më tutje.
- Edhe këtë vit në degën “Përkujtimore”, u shënua 7 marsi –dita e mësuesit dhe 8 marsi dita e gruas. Mysafir i këtij manifestimi ishte mësuesja veterane z. Kimete Ahmeti ish punonjëse e sh. F. “ Zenel Hajdini” e cila foli për përvojën e saj shumëvjeçare në arsim. U shpërblyen edhe 3 punimet më të mira të lexuesve me temë nga kjo ditë e shënuar. Pati edhe një program te pasur kulturor të përgatitur nga lexuesit e rregullt të kësaj dege të bibliotekës.

- 2 Prilli –Dita Ndërkombëtare e librit për fëmijë e të rinj, këtë vit u shënua në degën “Biblioteka Përkujtimore”. Të ftuar ishin shkrimtari i njohur për fëmijë Viktor Canosinaj dhe Shefi i Sektorit për Kulturë të R. së Shqipërisë z. Ermir Nika. U lexua mesazhi “ Unë jam bota” të shkruar nga autori egjiptian Hani D. El Mosri, gjithashtu edhe mesazhi po nga i njëjti autor. Ky aktivitet u përcoll me disa pika muzikore të përgatitura nga lexuesit e bibliotekës.
- Pasdite në ora 18.00 u promovua libri “ Meriyll” i autorit Viktor Canosinaj, librat e të cilit ishin ndër më të lexuarat të shpallura në vitin 2008, në bibliotekën tonë. Një vlerësim për këtë libër dhe librat tjera të këtij shkrimtari e bëri shkrimtari ynë i njohur për fëmijë Arif Demolli. Edhe shkrimtari bëri një bashkëbisedim me fëmijët rreth librit Meriyll dhe u befasua nga lexueshmëria e librave të tij në Kosovë
- Me 24 dhjetor në “Bibliotekën Përkujtimore” u mbajt manifestimi tradicional i ndarjes së Shpërblimeve për lexuesit më të dalluar, librave më të lexuara dhe mirënjohjeve për ata që ndihmuan bibliotekën në pasurimin e fondeve. Me këtë rast u hap edhe ekspozita e titujve të rinj të bibliotekës.

0Lexuesit më të dalluar:

Nga dega “Përrallat”

Labërie Lecaj kl. IV / 3 sh. f.”Hasan Prishtina”

Nga dega “Lektyra”

Liridon Islami kl. VI / 1 sh. f. “Hasan Prishtina”

Dega “Biblioteka Përkujtimore”

Trëndëlina Zhitia kl VII sh. F. “Gjergj Fishta”

Spektori për fëmijë:

Safo Xhigoli kl. VIII 5 sh. f.. “Elena Gjika”

Nga Spektori për të rritur:

Ylber Shyti- student tel.

Librat më të lexuara nga fëmijët:

Petro Marko: Fantazma dhe plani 3+4

Meri Poup Osborn- kompleti i veprave

Arif Demolli: Njeriu i blertë

Jaoan Vys: Familja Robinson

Nazmi Rrahmani: Malësorja

Librat më të lexuara nga të rriturit:

Ismail Kadare –vepra

Brunilda Zllami- vepra

Dan Braun

Paolo Coelho

Daniel Steel

Mirënjohjet:

Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport
Drejtorisë për Arsim dhe Kulturë të Komunës së Prishtinës
Instituti i Historisë- Prishtinë
Shtëpia botuese “Dukagjini”
Nexhip Habibaj:
Lekë Shehu, nxënës i kl. VII2 sh. f. Xh. Mustafa”
Goneta Peçanit:
Për kontributin e dhënë në aktivitetet kulturore

Punët dhe shërbimet teknike (financiare, administrative, të furnizimit, mirëmbajtjes, rojës etj.)

- Janë punë të kryera brenda Sektorit të Financave dhe të administratës. Punët që kreu ky sektor janë ndër më të ndryshmet. Janë evidencuar të gjitha hyrje-daljet e mjeteve financiare, si nga anëtarësimi i lexuesve, ashtu edhe mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës dhe Komuna. U bë kalkulimi dhe regjistrimi i të gjitha faturave hyrëse të këtyre mjeteve, është përgatitur Projekti buxhetor i Bibliotekës për vitin 2009 dhe raporti financiar në çdo tre muaj dhe është dërguar në Ministrinë e Kulturës.
- Janë evidencuar dhe sistemuar të gjitha dokumentat zyrtare. Është bërë furnizimi i të gjithë sektorëve dhe degëve me material bibliotekar dhe të pastrimit.
- Është intervenuar në raste të ndryshme për riparimin e defekteve të paraqitura dhe kujdesur për mirëmbajtjen e objektit të vjetëruar në të gjitha degët.
- Ky sektor është kujdesur edhe për mbajtjen e evidencës së përditshme të ardhjes në punë, si dhe pranimit dhe ruajtjes së dokumentacionit nga pushimet vjetore dhe mjekësore.
- Ky Sektor është kujdesur edhe për punën e pastrimit të objektit të bibliotekës dhe të degëve të saj.
- Është bërë regjistrimi i inventarit dhe pronës së Bibliotekës nga komisioni i caktuar nga ana e drejtorit të bibliotekës dhe është dërguar një kopje në MKRS dhe një në Komunë.

Botimet:

- Në muajin dhjetor u botua libri profesional me temë nga bibliotekaria me titull ” Biblioteka publike drejt reformave” i autorit Sylejman Pireva, punëtor shumëvjeçar i bibliotekës dhe drejtues i kësaj biblioteka që nga viti 1999-2009. E botoi dhe e financoi biblioteka ndërkomunale “Hivzi Sylejmani”.
- Biblioteka ishte botues edhe i librit me poezi të autores së re Hyrije Mehmatit(Mengjiqi) nxënëse e shk. së mesme S. Frashëri.

- **Promovimet:**

- Në bibliotekën Përkujtimore u bë Promovimi i librit me poezi të autores së re Hyrije Mehmeti(Mengjiqi) nxënëse e shk. së mesme S. Frashëri. Redaktori i librit Hysni Matoshi foli për vlerat letrare të kësaj autoreje të re.

Ekspozitat:

- Herë pa herë ka pasur ekspozita të punimeve të lexuesve në degët e bibliotekave ku punohet me fëmijë, të cilat janë ekspozuar në ambientet e bibliotekës.
- Më 24 dhjetor në kuadër të manifestimin të Ndarjes së shpërblimeve dhe mirënjohjeve u hap ekspozita e titujve të librave të rinj që kanë hyrë në bibliotekë gjatë vitit 2009.

Renovimet dhe pajisja me inventar

- Është bërë gëlqerosja e objektit të Bibliotekës Përkujtimore (jashtë dhe brenda), Izolimi i aneksit për shërbimin e lexuesve.
- Punimi i tavolinave dhe rafteve për Sallë të leximit, sektorin e fëmijëve dhe bibliotekës Përkujtimore.
- Janë blerë gjithsejtë këtë vit me mjete vetanake 8 kompjuterë, 1 lap-top, 2 printerë dhe pajisje tjera teknike për nevojat e bibliotekës.
- Janë blerë gjithashtu edhe 18 karrige lëvizëse për punëtorët në qendër dhe degë.
- U aprovuan edhe dy projekte shumë me rëndësi për bibliotekën: Hapja e Web- faqes dhe Logoja e bibliotekës. Logoja është bërë ndërsa Web-faqja është duke u plotësuar me shënimet e nevojshme. Është aprovuar edhe projekti për pajisjet e zërimit, gjithashtu projekt me rëndësi.

**Prishtinë,
27dhjetor 2010**

**Drejtori,
Munish Hyseni**